Programi për Financimin e Investimeve të Gjelbra në Ballkanin Perëndimor III

Vendi:Rajonale
Numri i Projektit: 53344
Sektori i Biznesit:Institucione Financiare
Lloji i Njoftimit:Privat
Kategoria Mjedisore: Institucione Financiare
Data e Aprovimit: 06 Shtator 2022
Statusi: **Aprovuar**
Dokumenti Përmbledhës i Projektit: 04 Maj 2022

Përshkrimi i Projektit

Krijimi i Programit të Financimit të Ekonomisë së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor ("WB GEFF III" ose Programi") në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi (së bashku, Ballkani Perëndimor ose BP) për 170 milionë euro në financime totale për institucionet financiare partnere të kualifikuara me qëlllim financimin e investimeve të gjelbra në sektorin rezidencial dhe publik në përputhje me qasjen e Bankës për Tranzicionin drejt Ekonomisë së Gjelbër. Programi mbështetet nga Bashkëpunimi Teknik dhe grante sipas dispozitave të Programit të Financimit të Ekonomisë së Gjelbër.

Objektivat e Projektit

Projekti mbështet investimet në ekonominë e gjelbër përmes masave për mbështetjen e efiçencës së energjisë dhe energjisë së rinovueshme në përputhje me qasjen e Bankës për Tranzicionin drejt Ekonomisë së Gjelbër. Programi është në vijim të Programeve ekzistuese për Financimin e Investimeve të Gjelbra në Ballkanin Perëndimor I dhe II duke zgjeruar përftuesit përfundimtarë me kompanitë e ndërtimit në sektorin rezidencial për ndërtime me performancë të lartë të efiçencës së energjisë dhe për të përshpejtuar tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër ne sektorin publik në nivelin e tregut rajonal.

Impakti në Tranzicion

ETI: 70

Projekti kontribuon në Cilësinë “E gjelbër” të impaktit në tranzicion duke ndihmuar në adresimin e çështes së karbonizimit dhe konsumit të lartë të energjisë në ndërtimet rezidenciale dhe në sektorin publik në rajonin e Ballkanit Perëndimor përmes rritjes të kapaciteteve lokale të institucioneve financiare partnere me qëllim huadhënien e gjelbër që do ta çojë Ballkanin Perëndimor drejt një ekonomie të gjelbër, me karbonizim të ulët dhe rezistente ndaj ndryshimeve mjedisore dhe klimatike. Të gjithë fondet e alokuara për

Institucionet Financiare Partnere nën këtë program do të përdoren për projekte që klasifikohen si 100% të gjelbra (GET) .

Informacion për Klientin

Institucionet Financiare Partnere do të jenë institucione financiare (banka, institucione të mikrofinancës dhe institucione të tjera kreditimi) që janë të themeluara dhe zhvillojnë aktivitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Financimi i BERZH

EUR 120,000,000.00

Deri më EUR 170,000,000

Kosto Totale e Projektit

EUR 170,000,000.00

Deri më EUR 170,000,000

Vlera e shtuar

Vlera e shtuar arrihet përmes kombinimit të financimit afatgjatë që nuk është i disponueshëm nga burimet tregatre për investimet e gjelbra me mbështetjen teknike, instrumenta të dedikuara për investimet si grantet dhe zhvillimi i politikave për promovimin e investimeve në ekonominë e gjelbër në ndërtimet rezidenciale dhe sektorin publik. BERZH mbetet Institucioni i vetëm financiar Ndërkombëtar në rajon që mbështet investimet e gjelbra në këta sektorë në një mënyrë gjithëpërfshirëse. Programi WBGEFF III synon të prezantojë një qasje për trajtimin e aspektit gjinor.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria Institucione Financiare (ESP 2019): është parashikuar se institucionet financiare partnere nën këtë program që janë klientë ekzistues të Bankës janë tashmë të familiarizuar me kriteret mjedisore dhe sociale të BERZH që aplikohen për institucionet financiare. Çdo institucion i ri financiar partner nën këtë program do të duhet të plotësojë pyetësorin e Vlerësimit Mjedisor dhe Social për Departamentin e BERZH Mjedisor dhe Social. Përfituesit e financuar nga ky program do të duhet të përmbushin kriteret mjedisore kombëtare, standartet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe kriteret mjedisore dhe sociale për projektet e energjisë diellore, hidrike, eolike, të bio-energjisë dhe gjeo-termale si dhe kritere të tjera të aplikueshme nën Politikën për Tranzicionin drejt Ekonomisë së Gjelbër. Kjo do ti komunikohet Institucioneve Financiare Partnere nga një konsulent për llogari të BERZH. Të gjithë institucionet nën këtë program do të duhet të përmbushin Kriteret 2, 4 dhe 9 të Performancës, dhe të dorëzojnë raporte vjetore mjedisore dhe sociale në Bankë përfshirë raportimin për nën-projekte dhe përfitimet nga Tranzicioni drejt ekonomisë së gjelbër dhe

do të duhet të aplikojnë Procedurat e BERZH për Menaxhimin e Riskut Mjedisor dhe Social për huatë ndaj korporatave, SME-ve dhe mikro-kreditë.

Bashkëpunimit teknik dhe financimi me grante

Programi do të mbështetet nga një paketë e bashkëpunimit teknik prej 6.4 milionë euo që do të implementohet nga Konsulenti I Programit. 4.5 milionë euro për bashkëpunimin teknik janë ofruar nga Bashkimi Europian nën Platformën për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF) dhe nga qeveria e Japonisë përmes Fondit të bashkëpunimit Japoni-BERZH.

Kontakti i Kompanisë

N/A

Data e përditësimit të dokumentit

04 Maj 2022

Materiale të ngjashme

- Translation: Western Balkans GEFF III (Serbian)
  Type: PDF, Published: 15.03.2023, Language: Serbian
- Translation: Western Balkans GEFF III (Montenegrin)
  Type: PDF, Published: 15.03.2023, Language: Montenegrin
- Translation: Western Balkans GEFF III (Macedonian)
  Type: PDF, Published: 10.03.2023, Language: Macedonian

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH.

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së Qasjes në Informacion; dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e ëebit për Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjsinë ndaj Projektit për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të dërguar një kërkesë për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.